



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA VI
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr.15
Prishtinë, më 3.5.2018, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Igor Simiq, kryetar i komisionit, Xhelal Sveçla dhe Danush Ademi zëvendëskryetarë; Kujtim Shala, Fadil Beka, Zoran Mojsilović, Jasmina Zhivković, Sasha Milosavljević, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Serbica- Shinik, Duda Balje, Slobodan Petrović dhe Veton Berisha, anëtarë.

Nga pjesëmarrësit tjerë: Senad Karaahmetović -pëfaqësues i OSBE-së; mediat e RTK-së dhe Kosova Press; Zijush Ahmeti, këshilltar i Sekretariatit të KKK-së dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: koordinatorë–Natasa Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu-zyrtare e lartë e fushës.

Mbledhjen e kryesoi: kryetari i Komisionit - Igor Simić.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Raportim për sfidat rreth zbatimit të Ligjit për përdorimin e gjuhëve;**
I ftuar: komisionari për gjuhët, z. Sllavisha Mlladenović;
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal;**
4. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari, në fillim i informoi anëtarët e komisionit, se mbledhja e caktuar më datën 30.4.2018 nuk është realizuar nga se Kuvendi ka pasur ditë pushimi, me rastin e festës së 1 Majit. Për arsyet e lartcekura, mbledhjen e komisionit e kam ftuar për sot, me të njëjtin rend të ditës.

Gjithashtu, i njoftoi anëtarët e komisionit, se në takimin e sotëm nuk do të marrë pjesë komisionari për gjuhët, Sllavisha Mlladenović, sepse ai më ka informuar se e ka agjendën e ngarkuar. Sipas informatës së tij, më datën 3 dhe 4 maj, KPJ, në bashkëpunim me Presidencën, ka organizuar një konferencë ndërkombëtare të oficerëve gjuhësorë.

Njëherit, ai ka propozuar që ditën e enjte të ftohen edhe anëtarët e komisionit, për të marrë pjesë në një koktej të shkurtër, me përfaqësuesit e Kanadasë, Mbretërisë së Bashkuar (Uellsit), Irlandës, Belgjikës, Spanjës, që të diskutohet për përvojat e tyre.

Sa i përket çështje së dy gjuhësisë, është problem me të cilin ballafaqohen çdo ditë deputetët e Listës Serbe, sidomos në rastet kur shqyrtohen projektligjet dhe dokumentet tjera me rëndësi. Për këto arsye, përsëri do të ftohet në komision komisioneri, i cili do të japë shpjegime më të hollësishme lidhur me aplikimin dhe sfidat e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

Kryetari, konstatoi se anëtarët e komisionit u pajtuan unanimitisht me propozimin të hiqet pika e dytë e rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Kryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit që të deklarohen, nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim në raportin me amendamente të Komisionit funksional.

Xhelala Sveçla, kishte vërejtje në titullin e ligjit dhe propozoi që fshihet fjala “nga” dhe të zvendësohet me fjalën “për”.

Administrata mbështetëse e komisionit dha sqarime shtesë se ky gabim është lëshim teknik dhe këtë vërejtje do e përcjellim zyrës koordinuese që mbështet Komisionin për Zhvillim Ekonomik Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Pas diskutimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, u pajtua unanimitisht që të miratohet raporti me amendamente i Komisionit funksional, dhe nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr.06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit dhe konstatoi se projektligji nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në seancën plenare të Kuvendit.

3. Të ndryshme

Veton Berisha, theksoi se në mbledhjen paraprake, në pikën të ndryshme, është shqyrtuar çështja e nismës legjislative të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-064 për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës, me propozim që në Ditët Memoriale të shtohet ‘24 Qershori’, ditë e egjiptianëve. Po ashtu, shpalosi realitetin se kjo çështje është dashur të jetë si pikë e rregullt e rendit të ditës.

Duhet theksuar se janë kryer aktivitetet e planifikuara dhe raporti është i gatshëm. Më tej, dha shpjegime shtesë se është marrë vendimi i pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së dhe vlerësimi për implikime buxhetore. Pasi kemi arrit në fazën përfundimtare, është i interesuar të informohet, pse i njëjti nuk është proceduar deri më sot ?

Ai dha disa propozime konkrete, në takimin e komisionit, të ftohet ministri për Punë të Brendshme, i cili do të raportojë lidhur me shpalljen e konkursit të policisë dhe për përfaqësimin e komuniteteve. Si propozim i dytë, në takimin e radhës, të ftohet ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, të raportojë lidhur me implementimin e projektit në vlerë prej 1.800.000 € projekt ky i dedikuar për ndërtimin e shtëpive për banim për komunitetin joshumicë dhe joserb. Gjegjësisht, të ofrojë informata lidhur me ndarjen e vijës buxhetore, e cila i takon të ndahet edhe për komunitetin egjiptian. Në kuadër të informatave që ka, bëhet fjalë për tejkallim të kompetencave, dhe nëse vazhdohet në këtë mënyrë, mund të them se është duke u shkelur Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Duda Balje, nuk u pajtua me propozimin e Veton Berishës, që të ftohet në komision, ministri i PMS-së, Skënder Reçica, pasi i njëjti nuk është kompetent të ndajë mjete buxhetore për projektin e ndërtimit të shtëpive për banim. Ai mund vetëm të zbatojë implementimin e projektit në praktikë. Po ashtu, theksoi se me iniciativën e GP 6+ është propozuar amendamenti për projektin e ndërtimit të shtëpive për banim për komunitetin joshumicë dhe se ky fond është ndarë nga Ministria e Financave, në vlerë prej 1.800.000 € dhe ky kod është përfshirë në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2018.

Danush Ademi, nuk është i të njëjtit mendim, pra që të ftohet ministri i MPMS-së, pasi i njëjti nuk është përgjegjës në ndarjen e mjeteve buxhetore për projektin e ndërtimit të shtëpive për banim. Kjo çështje i takon dikasterit të Ministrisë së Financave.

Ai veçoi se projekti është propozuar nga GP 6+, për ndërtimin e shtëpive për banim, në vlerë prej 1.800.000 € për komunitetin joshumicë dhe joserb. Sipas mendimit të tij, Qeveria është ajo e cila ka pasur vullnet të mirë për miratimin e të njëjtës. Duhet theksuar, se deputeti Berisha, në atë periudhë nuk ka qenë pjesë e Grupi Parlamentar 6+, andaj nuk është korrekte nga ana e tij të paraqesë ankesa që nuk kanë bazë juridike.

Mendoj se është një moment i mirë, të ftohet ministri i MKK, i cili do të raportojë për vijën buxhetore të ministrisë resore. Edhe pse ndër vite, kjo ministri nuk ka treguar vullnet të mirë që të investojë në projektet e ndryshme kapitale, në emër të komunitetit joshumicë.

Veton Berisha, pas diskutimeve të kolegëve, ai përsëriti kërkesën që komisioni të ftojë ministrin e MPMS-së, i cili është përgjegjës të raportojë lidhur me procedurën e implementimit të nenit 12 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2018, ligj ky i cili është votuar në Kuvend. Duhet theksuar se ndarja e mjeteve buxhetore, në vlerë prej 1.800.000 €, parasheh se kjo shumë duhet t'jetë e destinuar edhe për komunitetin egjiptian.

Sipas mendimit të tij, nuk është e drejtë e asnjë ministri të ndajë mjete buxhet në emër të një komuniteti, ndërsa kategoria tjetër të anashkalohet. Nëse vazhdohet me situatë të tillë, konsideron se shkelet Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Albert Kinolli, në faktë është i vërtetë diskutimi i dhënë nga z. Berisha, se projekti për ndërtimin e shtëpive dedikohet për komunitetin joshumicë dhe joserb.

Ai konstatoi se GP 6+ e ka iniciuar kërkesën për projektin e ndërtimit të shtëpive për banim. Projekti për mbështetje të komuniteteve, bazohet në nenit 12 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2018, i cili nen parasheh ndarjen e mjeteve buxhetore në vlerë prej 1.800.000 € Duhet theksuar se Grupi Parlamentar 6+, përbëhet prej katër komuniteteve: komunitetit turk, boshnjak, rom dhe ashkali.

Po ashtu, veçoi se kërkesa jonë ka hasur në mirëkuptim të mirëfilltë nga ana e Kryeministrit, ministrit të Financave dhe ministrit për PMS. Tani jemi në fazën e pritjes, që ky projekt të implementohet sa më parë.

Më tej, theksoi se nuk pajtohet me diskutimin e kolegut Berisha, i cili paraqiti reagime të shumta e të cilat nuk kanë bazë dhe nuk janë të drejta. Nëse ka vullnet për zgjidhjen e këtij problemi, ekziston mundësia që ai të dalë me propozim konkret, por gjithnjë duke pasur parasysht se komisioni është ai i cili vendos për procedim të mëtejshëm apo jo.

Më pas, dha sugjerim për z. Berisha, është mirë të vazhdojë me procedurën e nismës legislative për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Festat Zyrtare, me qëllim që të shtohet '24 Qershori', ditë për egjiptiantë, E rëndësishme është që edhe ky komunitet të jetë i përfshirë me këtë ligj.

Duda Balje, lidhur me çështjet e ngritura, dha propozim konkret, që në një takim të përbashkët të komisionit, të ftohen dy ministra: ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe ministri i Komuniteteve dhe Kthim, të cilët janë kompetentë t'u përgjigjen pyetjeve tona, më pas, komisioni, do të dal me shkresa të cilën do ta procedohen më tej.

Sipas qëndrimit të saj, mendon që ky propozim duhet të hedhet në votim.

Kujtim Shala, përkrah mendimin e Veton Berishës, që komisioni të ftojë ministrin e MPMS-së, i cili do të raportojë lidhur me implementimin e nenit 12 të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2018, gjegjësisht për realizimin e projektit për komunitete.

Po ashtu, konsideroi se është e drejtë e secilit deputet të paraqes propozimet apo sugjerimet e veta. Shpeshherë ndodh që një deputet të propozojë ndonjë amendament dhe i njëjti të miratohet në Kuvend, por nuk do të thotë se kjo çështje ka të bëjë me origjinën e propozuesit.

Perceptimi im është se nëse bëhet ndarja e fondeve për komunitetin joshumicë, në mënyrë jo-proporcionale, atëherë ekziston dyshimi se ka bazë për cenim të Kushtetutës.

Duhet theksuar se vërejtje ka pasur edhe më herët për ministrin e Komuniteteve dhe Kthim. Këtë e them, duke u bazuar në mbledhjen e komisionit, me rastin e raportimit të zëvendësministrit të Ministrisë së Financave, në atë rast, kam dhënë propozim konkret për ministrin e KK, që i njëjti të dërgojë pasqyrën financiare me emra, mbiemra dhe shifra. Ky raport me të gjetura do të ndihmonin në pasqyrimin e qartë dhe transparent të shpenzimeve.

Gjithashtu, është i mendimit të njëjtë që të ftohen në Komisioni dy ministrat e propozuar, me qëllim të marrjes së opinioneve të tyre.

Kryetari, theksoi se është e drejtë e komisionit, që të ftojë në takim ministrin e MKK, Dalibor Jevtiq, jo vetëm për temat e ngritura nga kolegët, por janë të interesuar edhe komuniteti serb, me qëllim të adresimit të drejtë në temat që janë me interes vital, në interes të komuniteteve.

Në një takim me Ministrin e MPMS-së, anëtarët e SL do të diskutojnë çështje të një natyre tjetër. Kemi një situatë specifike, bëhet fjalë për qytetarët që jetojnë në pjesën veriore të Mitrovicës dhe iu kërkohen dokumente shtesë nga institucionet e Kosovës, në fakt, këto dokumente lëshohen vetëm nga institucionet serbe. Gjithashtu, një nga qëllimet tona është integrimi i Veriut në rrjedhat e rritjes së cilësisë së jetës dhe ngjarjeve të tjera të rëndësishme.

Albert Kinolli, ai foli në emër të GP 6+, dhe kërkoi nga kryetari të ketë mirëkuptim dhe mos të caktojë takimet e komisionit në të njëjtën ditë kur mbahen mbledhjet e seancës plenare, ngase në të njëjtën kohë janë lutjet e mëngjesit, takimet e grupit parlamentar. Shpeshherë ndodh që në të njëjtën kohë shqyrtohen projektligjet apo çështjet me rëndësi të veçantë, ndërsa kërkohet të ketë kuorum për votim. Shpreson se kjo praktikë nuk do të përsëritet në të ardhmen.

Nuk pajtohet me qëndrimin e z. Shala, se propozimi i dhënë nga GP 6+ paraqet shkelje kushtetuese. Qëndrimi ynë është shumë i qartë dhe i drejtë, ngase është kërkuar me kod të veçantë të rregullohet ndarja e shumës financiare, në vlerë prej 1.800.000 € Kjo çështje nuk kërkon interpretim juridik, pasi të drejtat e komuniteteve garantohen me Kushtetutë.

Kujtim Shala, dha sqarime shitesë se ka pasur keqkuptime nga kolegu. Unë jam shprehur se rasti është kundër Kushtetutës, kur nuk ndahen mjetet financiare në mënyrë proporcionale për komunitet, siç është rasti i Vetonit, i cili pretendon se është bërë shmangie ligjore për komunitetin egjiptian. Pra, është e drejtë e secilit anëtar të komisionit të paraqesë kërkesa, kur e konsideron si të nevojshme për trajtimin e problemeve të komunitetit të tij.

Kryetari, dha sqarime shitesë se mbledhja e komisionit ka qenë e ftuar me datë 30.4.2018, ndërkohë jam informuar nga administrata e komisionit, se me këtë datë Kuvendi ka ditë pushimi. Për këtë arsye e kam caktuar takimin më datë 3.5.2018, para se të caktohet mbledhja e seancës plenare. Për korrektësi, dha informatë se disa anëtarë të këtij komisioni më bëjnë trusni të caktojë mbledhje, me qëllim që të realizohet mundësia e plotësimit të kuotës, ndërsa propozimet e tilla, unë gjithmonë i kundërshtoj. Ai konstatoi se takimet e rregullta të komisionit do të mbahen vetëm në rastet kur do ketë material për shqyrtim.

Sllobodan Petroviç, lidhur me diskutimin e kryetarit, kërkoi të informohet se cilët janë ata deputet të cilët bëjnë presion që të mbahen mbledhje, edhe për kundër faktit se nuk ka material për shqyrtim.

Kryetari, nuk ishte i interesuar të flasë lidhur me këtë çështje, pasi ai veq ka dhënë shpjegime.

Kryetari, konstatoi se në takimin e sotëm u dhanë dy propozime: të ftohet ministri për Punë të Brendshme, në cilësi të raportojë lidhur me shpalljen e konkursit të policisë dhe përfaqësimi i komuniteteve.

Dhe nën dy, në takimin e përbashkët, të ftohet ministri i Punës dhe Mirëqenie Sociale dhe Ministri i Komuniteteve dhe Kthim, të raportojnë lidhur me implementimin e projektit për ndërtimin e shtëpive për komunitetin joshumicë.

Pas diskutimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

Përfundim

- I. *Komisioni, me shumicë të votave, miratoi propozimin që të ftohet ministri për Punë të Brendshme, që të raportojë për shpalljen e konkursit për punësim të policisë në SHPK dhe përfaqësimi i komuniteteve.*
- II. *Komisioni, me shumicë votash, miratoi propozimin që në takim të përbashkët të ftohet ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe ministri i Ministrisë së Komuniteteve dhe Kthim, me qëllim të raportimit lidhur me implementimin e projektit për ndërtimin e shtëpive për banim për komunitetin joshumicë.*

Kryetari, theksoi se pika e rendit të ditës, të ndryshme, është propozuar nga deputeti Veton Berisha, që të iniciohet nisma legislative e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës, të ndryshohet neni 5.5 i ligjit dhe në Ditët Memoriale të shtohet ‘24 Qershori’, ditë për komunitetin egjiptianë.

Sa i përket çështjes së procedimit të këtij projektligji, i vërtetë është fakti se kam pranuar nga deputeti Veton Berisha një dokument apo thënë, vendim, dhe sa unë kam kuptuar, bëhet fjalë për marrjen e mendimit të Qeverisë, për të cilën çështje nuk janë dakorduar, ngase komisioni ka të drejtë të fillojë nismën legislative të projektligjeve, pa qenë e nevojshme të merret qëndrimi i Qeverisë dhe kjo është arsyeja e vetme, pse nuk e kam nënshkruar dokumentin në fjalë.

Duhet theksuar se në bazë të nenit 53 të Rregullores së Punës së Kuvendit, propozimin për projektligje në Kuvend mund të paraqesë Presidenti i Republikës së Kosovës, nga fusha e veprimtarisë së tij, Qeveria, deputetët e Kuvendit, komisioni parlamentar, grupi parlamentar. Në vazhdim, i informoi anëtarët e Komisionit, se GP i Listës Serbe do të hartojë amendamente me propozim që të shtohet data 15 shkurt dhe 28 qershor, ditë memoriale për komunitetin serbë.

Pas konsultimeve, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë:

Përfundim

- I. Në mënyrë unanime, komisioni miratoi nismën legislative të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-064 për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës, me propozimin e Veton Berishës, që në 'Ditët Memoriale', të shtohet data '24 Qershor', ditë e egjiptianëve dhe propozimi i dhënë nga GP i Listës Serbe.*

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

Procesverbali u hartuan nga stafi mbështetës i komisionit.

Kryetar i komisionit,

Igor Simić